

## **Shoqata Rreze Shprese**

- Ka si qëllim kryesor përmirësimin e shërbimeve me bazë komunitare për personat me aftësi ndryshe kryesisht dhe e ushtron fushën e veprimit tek veprimtaritë Social Edukative që nxisin frymën e solidaritetit njerëzor në shërbim të komunitetit me fokus të veçanta fëmijet autike.
- Jep mbështetje për projektet e shërbimit shoqëror për personat me autizëm, sipas standardeve të monitoruara nga RREZE SHPRESE.
- Kryen shërbime këshillimore për prindërit, për aplikimin dhe vlerësimin e arritjeve rehabilituese dhe të kryerjes së shërbimeve të vetëkujdesjes dhe integritit.
- Përhap përvojën në nivel bashkie dhe me gjerë për shërbimet me bazë komunitare sipas modelit të standardeve të miratuara.
- Bën vlerësimin e nevojave të personave me autizëm, i hedh ato në database dhe i vë në dispozicion të Bashkisë sa herë që është nevoja.
- Bashkëpunon me organet në nivel vendor edhe në arsim për rritje kapacitetesh dhe burimesh.

## **Caritas Dioqezan bashkëpunon me famullitë dhe entet rregulltare për :**

- Identifikimin, verifikimin dhe zgjedhjen e prioriteteve të nevojave në dioqezë.
- Ndiemon, zbaton projekte, zhvillon veprimtari të ndryshme në bashkëpunim me famullitë dhe misionet katolike të dioqezës
- Bashkëpunon ngushtë me Caritas Shqiptar.
- Bashkëpunon me Caritase si motra të vendeve të ndryshme, me shoqata, ente vendase e të huaja si dhe me organizma shtetëror e privat.
- Promovimi i dashurisë së krishterë;
- Ofrimi i veprave të bamirësisë në komunitet pa asnjë dallim feje apo etnije;
- Garantimi i destinacionit të fondeve;
- Zbaton normat e Kishës Katolike dhe udhëzimet e Arqipeshkvit;

Respekton ligjet në fuqi të shtetit shqiptar